



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr.39, datë 25.06.2025

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR SIPËRFAQËSOR, ME QËLLIM KRIJIMIN E PISHINAVE, ME
VENDNDODHJE NË BASHKINË DURRËS, ME SUBJEKT
ZHVILLUES SHOQËRINË “DURRËS MARINA” SH.A**

Në mbështetje të nenit 8, pika 3, gërma (a) dhe nenit 141, pika 3 të ligjit Nr.29/2024 “Për burimet ujore” i ndryshuar, Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar si dhe Vendimit Nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor, me qëllim krijimin e pishinave, me vendndodhje në bashkinë Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Durrës Marina” sh.a.
2. Vendodhja e burimit ujor (koordinatat KRGJSH).

Vendndodhja e burimit ujor për Pishinën 1:



X-454816.3; Y-4575215.6; Z-0.7m;

Vendndodhja e burimit ujqor për Pishinën 2:

X-455479.1; Y-4575620.2; Z-0.7m;

Emri i burimit ujqor: Deti Adriatik.

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet: Përdorimin e burimit ujqor të Detit Adriatik për dy pishinat si pjesë përbërse të projektit "Marina & Jahtet e Durrësit, Faza-1" në detin Adriatik, Durrës.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi;

Ky vendim pas nënshkrimit, hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLEUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



DREJTOR I AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

ANILA SHEHU



Nënshkruar më datë 17/07 2025